

# *Pengmarrja e lajmit (newsjacking) - teori konspirative apo taktikë për konsumin e mediave ndërkombëtare, Krimeja dhe Kosova*

*Eva Londo\**

## **Abstrakt**

Në mars të vitit 2014-të, kur mediat ndërkombëtare po reagonin dhe kundërshtonin ndërhyrjen ushtarake të ushtrisë ruse në territorin e Ukrainës, në provincën e Krimesë, një deklaratë e fuqishme e presidentit rus Vladimir Putin ndryshoi mbulimin mediatik të ngjarjes. Ai deklaroi se “Krimeja është Kosovë” dhe se aneksimi i Krimesë nga Ukraina është i ngjashëm me aneksimin e Kosovës nga Serbia dhe çdo argument tjetër është veçse një përpjekje për të thyer rregullat që perëndimi aplikoi në rastin e Kosovës. Kjo deklaratë i dha startin një lufte mediatike që nuk ishte parë ndonjëherë më parë, duke hequr vëmendjen e opinionit publik nga ngjarja e vërtetë dhe duke ushqyer një lloj konspiracioni informativ që kalonte përtej kanaleve diplomatike. Ky punim do të bëjë një analizë të thelluar të mënyrës se si politika e jashtme përdor teknika të marrëdhënieve me publikun për të qenë e pranishme në mediat globale. Nga ana tjetër, punimi do të bëjë një analizë të mënyrës se si mediat bëhen subjekt i teorive konspirative të shteteve në marrëdhëniet ndërkombëtare

**Fjalë kyç:** *newsjacking, Kosova, Krimeja, luftë mediatike, Putin*

---

\* Dr. Eva Londo, Departamenti i Gazetarisë dhe Komunikimit – Universiteti i Tiranës. E-mail: [londo\\_e@yahoo.com](mailto:londo_e@yahoo.com)

## **Qasje teorike**

Revolucioni i komunikimit dhe ai i informacionit kanë nxitur gazetarët të ndërmarrin, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose jo, rolin e ndërmjetësit në shumë konflikte ndërkombëtare. Ata krijojnë hapësira mediatike për të transmetuar informacione rreth ngjarjeve konfliktuale nëpër botë. Por, ndërkohë që politika e jashtme është një domen shumë specifik dhe në kushtet e sensibiliteteve ndërshtetërore që krijohen gjatë konflikteve, dy janë pyetjet që parashtrihen në mënyrën se si mediat ndërlidhen me diplomacinë; A është ajo një urë alternative komunikimi mes palëve në konflikt, apo a përdoren mediat nga politika e jashtme për qëllime më madhore të një shteti? Larson vëren se “televizioni prezanton një kanal interaktiv për diplomaci, i cili është i shpejtë dhe aktual, dhe ku gazetarët ndërmarrin rol të barabartë me zyrtarët e politikës së jashtme në proceset e dialogut”<sup>1</sup>. Graber<sup>2</sup> shkruan se gazetarët po zëvendësojnë zyrtarët publikë duke marrë pjesë aktive në ngjarjet aktuale, si një grevë në burg ose një aksion diplomatik, dhe zgjidhja që vjen prej gazetarëve mund të “riformulojë veprimet politike të qeverisë”<sup>3</sup>.

Diplomatët dhe gazetarët bien dakord për rolin e këtyre të fundit, i cili shkon përtej raportimit rreth ngjarjes dhe proceseve duke krijuar kështu një model të “ri diplomacie”. Në këtë mënyrë duket se gazetarët bëhen diplomatët e rinj, çka po ndërton edhe një marrëdhënie të re mes tyre dhe diplomatëve profesionistë.

---

<sup>1</sup> James Larson, *Global television and foreign policy*. Foreign Policy association. New York: 1998. f. 43.

<sup>2</sup> Doris A. Graber. Doris A. *Mass media and American politics* (6<sup>th</sup> edition). Congressional Quarterly Press: Washington, DC: 2002.

<sup>3</sup> Po aty, f. 171-172.

Gazetarët bëhet ndërmjetës në shumë ngjarje të rëndësishë së veçantë të terrorizmit ndërkombëtar si p.sh. pengmarrja e teatrit të Moskës nga terroristët çeçenë, lufta në Irak në 2003, ndërhyrja ushtarake në Gjeorgji në 2008, sulmet terroriste në metronë e Londrës në 2009, sulmet vrasëse në Paris në 2013, ndërhyrja ushtarake në Ukrainë, vala e sulmeve vdekjeprurëse në Turqi apo grushti i shtetit. Përdorimi i mediave, veçanërisht televizionit për të transmetuar intervista të aktorëve të rëndësishëm të politikës së jashtme si p.sh., intervista me Sadam Husseinin, Slobodan Milosheviqin, apo deklaratat kërcënuese të elementëve terroristë në media kanë sjellë termin teleplomaci, për të përshkruar diplomacinë e televizionit. Gurevitch përshkruan mënyrën se si globalizimi i televizionit “mund të lansojë sipërmarrje raportuese që tentojnë të zbehin diferencat mes rolit të reporterëve dhe diplomatëve”<sup>4</sup>. Po ndërkaq që teknologjia po kontribuon më shpejt në avancimin e diplomacisë së re, edhe diplomacia tradicionale po avancojnë teknikat që ajo përdor për të vënë në funksion avantazhet e mediave.

### a) Metodologjia

Për këtë punim është bërë një monitorim i edicioneve të lajmeve të mediave CNN, Russia Today (RT) dhe portalin e Huffington post. Për secilin prej kanaleve është ndjekur minimalisht një edicion i lajmeve të drekës, për një periudhë dyjavore prej lansimit të deklaratës, pra që prej 18 marsit – 30 mars 2014. Më tej janë vëzhguar, në mënyrë rastësore, postimet e bëra në

---

<sup>4</sup> Gurevitch, Michael (1991) “The globalization of electronic journalism”. Në: James Curran, James & Michael Gurevitch (Ed). *Mass Media and society*. London: 1991 (178-193)

“Facebook” për periudhën mars-tetor 2014, nga grupe e individë që mbajnë qëndrime mbi çështjen.

**b) “Krimeja është Kosovë”- lansimi i lajmit në mediat ndërkombëtare**

Kosova po vihet edhe njëherë në qendër të betejës për supremaci, duke dhënë më shumë përmbajtje informative për mediat kombëtare dhe ndërkombëtare. Që prej periudhës që filluan përpjekjet e saj për pavarësi dhe ende sot, në përpjekje për sa më shumë njohje, Kosova është padyshim një lajm për çdo lloj të mediave. Dhe kur vetëm ditët e fundit po dëgjojmë frazën “Kosova është Serbi”, kujtesa e shumë studiuesve të politikës së jashtme apo të gazetarisë ndërkombëtare kthehet në vitin 2014, kur Putin ndërmori luftën më të madhe mediatike, në qendër të së cilës u vendos çështja e Kosovës. Në të njëjtin stil të ngjashëm siç po artikullohet së fundmi me kërcënimet kundër Kosovës duke pohuar “Kosova është Serbi”, në 2014 Kosova u vu në qendër të diplomacisë dhe mediave ndërkombëtare me deklaratën e fuqishme të presidentit rus Putin se “Krimeja është Kosovë”.

Ky studim do të trajtojë mënyrën se si diplomacia ruse përdori mediat në rastin e ndërhyrjes ushtarake në Ukrainë. Ajo parashtron një dilemë të rëndësishme në mënyrën se si mediat u bënë ndërmjetëse në përcjelljen e lajmeve që buronin nga konflikti, jo më si transmetuese e thjeshtë por si “viktimë” e strategjive të sofistikuara diplomatike.

Në mars të '99-tës, NATO ndërmori sulmin 76-ditor në Serbi, pas gjenocidit të ushtruar në Kosovën e banuar në masën 95% nga shqiptarë, nga forcat militare serbe. Ndërhyrja ushtarake e NATO-s ndodhi pas masakrës në Kosovë, atëherë provincë autonome e banuar në masën 95 % nga popullsia etnike shqiptare, e cila u shoqërua nga vrasje dhe dëbime masive të

popullsisë. Këto ngjarje u dokumentuan nga mediat ndërkombëtare, të cilat dhanë një kontribut parësor në vendimin e NATO-s për të lançuar fushatën ushtarake. Gazetarë ndërkombëtarë të stacionuar në kufirin mes Kosovës dhe Shqipërisë po dokumentonin varganët e gjatë të shqiptarëve etnikë që po detyroheshin me forcë të largoheshin nga territori i tyre dhe kishin gjetur strehë në Shqipëri. Në kushte shumë të vështira, me karroca, traktorë, në kohë klimatike shumë të vështira dhe në gjendje shumë të vështirë psikologjike ata po largoheshin si refugjatë drejt Shqipërisë, ku ishin ngritur kampe dhe ku familjet kishin hapur dyert e mikpritjes. Mediat ndërkombëtare “ushqyen” audiencën ndërkombëtare me imazhet e asaj që më pas u klasifikuan si gjenocidi i kohëve moderne, çka u pasua me krizën më të madhe humanitare të shekullit të kaluar, që u anatemia nga gjitha ligjet e humanizmit, moralit dhe ato ndërkombëtare.

Në 2014-tën, në kohën kur popullsia e Ukrainës dëboi presidentin e përzgjedhur pro-rus dhe formoi një administratë të orientuar drejt perëndimit, forcat militare ruse hynë në territorin e Ukrainës, në provincën e Krimesë, e banuar kryesisht nga popullsi etnike ruse. Këto forca u shtuan në mars të po atij viti, kur provinca e Krimesë kreu referendumin, i cili deklaroi një plebishit për pavarësi dhe aneksim nga Ukraina. Popullsia pro-ruse e mirëpriti vendimin, porse kjo solli një rritje të konfliktit mbi çështje të hegjemonisë mes Ruisë dhe Ukrainës, Ruisë dhe Perëndimit, Ruisë dhe ligjeve, Ruisë dhe mediave.

Ndërsa, shumë shtete po kundërshtonin këtë iniciativë ushtarake të Ruisë, Presidenti Vladimir Putin doli për të shpjeguar arsyen që qëndronte pas deklaratës së tij. Ai deklaroi se Krimeja ishte Kosovë. Ai citoi: “Ndarja e Krimesë nga Ukraina është e njëjtë si ndarja e Kosovës nga Serbia dhe çdo

argument që nuk e mbështet këtë është përpjekje për të thyer rregullat e vendosura nga Perëndimi, që janë aplikuar në rastin e Kosovës”<sup>5</sup>.

Përpjekja e Putinit për të bindur publikun ndërkombëtar mbi legjitimitetin e veprimeve të tij, më shumë sesa një përpjekje për këtë qëllim, ishte një deklaratë për të neutralizuar psikologjikisht opinionin publik në perëndim, të cilët e kishin vendosur atë me shpatulla për muri. Dy janë çështjet që ngrihen në këtë rast:

- 1- Aftësia retorike e Putinit për të rindërtuar një realitet të ri mbi krizën që justifikonte aksionin e tij, dhe
- 2- Të mbajë supremacinë e Ruisë mbi rajon, duke vendosur autoritetin e saj si ndërtuese e paqes, atribut që deri më tash e kishte mbajtur SHBA-ja. Ndërsa e dyta është gjeopolitikë dhe lidhet me përplasjet e gjata mes dy shteteve për hegjemoni, ajo që duket si analiza themelore për çështjen prezantohet te pika e parë.

Retorika e përdorur nga Putin për të rindërtuar krizën dhe rishpikur realitetin ishte një manovër taktike që u shërbente disa qëllimeve:

- a. përpjekjes së Putin për t’u përpjekur të arsyetojë veprimin e tij tek autoritetet perëndimore, jo sepse atë e shqetësonte kjo gjë më shumë, por sepse ai u përpoq të shkëpuste vëmendjen (edhe pse për një kohë të shkurtër) nga çështja më prevalente, që ishte ndërhyrja ushtarake;
- b. sepse kjo do të shkaktonte zhurmë në media, e cila do të fillonte të kërkonte rreth kësaj logjike të re që Putin u vendosi në mendje, duke sjellë kështu fakte të reja që, për hir të së vërtetës do t’i jepnin opinionit publik një

---

<sup>5</sup> Fragment nga deklarata e presidentit rus Vladimir Putin mbajtur ne parlamentin rus në 18 mars 2014.

përmbajtje të re dhe informacion të ri rreth veprimit të Ruisë.

Menaxhimi profesional i veprimit ushtarak që ai kishte ndërmarrë i dha një dimension tjetër veprimit në vetvete. Ndërkohë që, forcat ushtarake po përparonin në Krime, mediat vijuan të merren me informacionin e ri që u kishte propozuar Putin, një ish-agent i KGB-së dhe një specialist i teorive konspirative. Pozimi i ri i çështjes i dha asaj një dimension më global, madje inkurajoi më shumë debat ndër publikun ndërkombëtar, duke e internacionalizuar çështjen. Aftësia e Putin për të sjellë një dimension të ri të çështjes diplomatike që u krijua, habiti edhe faktorin ndërkombëtar, ndërsa gjenerali i lartë i NATO-s, Philip Breedlove, deklaroi se Rusia po përdor “bombardimin më mahnitës që është parë ndonjëherë në historinë e luftës së informacionit”<sup>6</sup>. Në këtë përpjekje, Putin kishte mbështetjen e mediumit transnacional Russia Today (RT), i cili transmeton deri në SHBA dhe mban linjën editoriale të qeverisë. Ditën e deklaratës RT publikon “Krimeja e ngjashme me Kosovën. Përfundimi po rishkruan librin e ri të rregullave”<sup>7</sup>, apo “Vetëm fakte: Kovosa vs Krime- “Pavarësi e mirë” vs “Referendum i keq”<sup>8</sup>”.

Sistemi i brendshëm i manipulimit të informacionit që Rusia tashmë e internacionalizoi, tregoi se si mediat mund të sillen si aktor i politikës së jashtme. Ndërsa Putin lëshoi “farën” e informacionit, mediat u lëshuan në histori të pafundme duke

---

<sup>6</sup> Deklaratë e dhënë nga Philip Breedlove, komandant suprem i NATO-s, gjatë Samitit të NATO-s në 4 shtator 2014

<sup>7</sup> Crimea similarities to Kosovo, the West is writing its own book of rules”, publikuar nga RT në 18 mars 2014

<sup>8</sup> “Only facts: Kosovo versus Crimea; Good independence – Bad referendum”, publikuar nga RT në 21 mars 2014

rrënuar në historinë e vendeve, kushtetutat, ligjet ndërkombëtare etj., për të ndërtuar lajme mbi ngjashmëritë apo ndryshimet rreth asaj që ndodhi në të dyja vendet. Ajo publikoi lajme pafund; Huffington post shkruajti përditë lajme mbi krahasimin Kosovë - Krime, si p.sh. më 18 mars "Krimeja nuk është Kosovë"<sup>9</sup> pasuar nga një tjetër lajm më datën 19 mars "Sa të ngjashme, apo jo, janë Krimeja dhe Kosova"<sup>10</sup> e përditë me radhë "Kosova dhe Krimeja: SHBA/BE Standarde të dyfishta"<sup>11</sup>, 23 mars. Po kështu edhe CNN ka trajtuar tema mbi këtë krahasim jo vetëm në edicionin informativ por edhe në emisionet e gazetarëve prestigjiozë. Në asnjë rast nuk është evidentuar asnjë lajm në përkrahje të ndërhyrjes ushtarake të Rusisë në Krime apo që të justifikonin deklaratën e hedhur nga Putin. Në 25 mars, në edicionin informativ transmetohet një intervistë e gazetares Christiane Amanpour me një ish-diplomat, kronikë, e cila transmetohet edhe në emisionin e përditshëm të gazetares, me titra "Pavarësisht pretendimeve të Putin, Kosova nuk ka asnjë 'ngjashmëri' me Krimenë"<sup>12</sup>, - fragment i cili është përdorur si titull për kronikën. Në këtë logjikë parashtroheshin të gjitha lajmet e transmetuara si nga CNN edhe nga mediumi online "Huffington post".

Madje mediat e zhvilluan edhe më tej diskursin e tyre duke bërë deduksione rreth asaj që kjo ngjarje parathoshte se mund

---

<sup>9</sup> "Crimea is not Kosovo", publikuar ne Huffington post në 18 mars 2014

<sup>10</sup> How similar or not, are Crimea and Kosovo" publikuar nga Huffington post në 19 mars 2014

<sup>11</sup> "Kosovo and Crimea: SHBA/BE double Standards", publikuar nga Huffington post në 23 mars 2014

<sup>12</sup> "Despite Putin claim, Kosovo bears 'no resemblance' to case of Crimea, Says former U.S. diplomat", publikuar nga CNN ne 23 mars 2014



të ndodhë në Skoci. Ky ritëm frenetik për të kërkuar informacion dhe për të krahasuar dy rastet zптоi, jo vetëm mediat, por edhe opinionin publik, të cilët, sipas monitorimit të bërë, bënin analiza të ngjashme në rrjetet sociale. Kështu, gjithë aktorët e sotëm të politikës së jashtme, falë retorikës propagandistike të qeverisë ruse, u pajisën me një përmbajtje të re dhe informacion të ri rreth veprimit të Ruisë, duke zhvendosur vëmendjen nga problemi i vërtetë. E në këtë situatë të re, ndërsa mediat po merreshin me deklaratën e Putin, televizioni rus Russia Today (RT) njofton në 21 mars firmosjen, nga ana e presidentit rus, të deklaratës së aneksimit të Krimesë. Kështu, makineria konspirative ruse po funksiononte duke shpërqendruar vëmendjen e opinionit publik, mediave dhe aktorëve diplomatikë dhe duke mos lënë hapësira për analiza diplomatike. Ndërkaq, veprimet e tyre politike të njëpasnjëshme jo vetëm që paraqisnin interes për politikën ndërkombëtare, por po ofronin një intensitet të lartë ngjarjesh duke mpirë opinionin publik dhe mediat. Rusia rikrijoi realitetin, duke krijuar halucinacione masive që më pas përkthehen në veprime politike. Është një pengmarrje perfekte e lajmit (**hijacking news**)<sup>13</sup> drejt mediave ndërkombëtare, me qëllim për të sjellë më shumë detaje për veprimet politike që në aspektin diplomatik çorientojnë autoritetet, mediat dhe opinionin publik duke krijuar një ngjarje të re prej një lajmi të mëparshëm.

---

<sup>13</sup> Monitorimi i lajmeve që mund të lidhen me klientin, në mënyrë direkte ose jo dhe lajmi 'kamikaz' përdor informacione të mëparshme dhënë nën një dritë të re duke ofruar një mundësi të re diskutimi ose përgjigje për një çështje që i shton lajmit më shumë peshë ose thellësi

### **c) Diskutime përfundimtare**

Është e qartë se qëllimi i kësaj forme të re propaganduese nuk është bindja por (a) përpjekja për të mbajtur shikuesit-audiençën të hutuar dhe të çorientuar dhe (b) për të zhvendosur narrativin aktual të Perëndimit më shumë sesa të jenë një përgjigje reaguese. Kjo metodë e përdorur është një zhanër perfekt për teori konspirative, të cilat gjenden me shumicë në mediat ruse, të dominuara nga qeveria. Realisht duket se era e informacionit është kapur peng nga makineria e "spin"-it, e cila përpiqet ta rikthejë Rusinë në kohën e Bashkimit Sovjetik. Megjithatë, shpejtësia me të cilën mediat u bënë subjekt i kësaj teknike manipulative të diplomacisë publike tregoi fuqinë që mund të ketë informacioni dhe përdorimin e tij si armë për të neutralizuar aktorët e politikës së jashtme. Më tej, ofrimi i një modeli të ri për të trajtuar lajmet në media, marrja dhe zhvillimi i këtij informacioni nga mediat ndërkombëtare tregoi fuqinë e saj në politikën e jashtme, ndërsa mënyra se si ai u ndoq, tregon format e westernizimit të informacionit.

Diplomacia u shokua nga forca që Kremlini i dha informacionit dhe mënyra se si ai e westernizoi dhe ridimensionoi atë për një konsum më global. Kjo është makineria informative e Rusisë për të mbajtur publikun konfuz, pasiv dhe inaktiv. Ndërkaq, edhe pse jetojnë në epokën e informacionit pa limit, publiku kupton më pak, pasi "spin"-i po zëvendëson të vërtetën, dhe kjo në përgjithësi po konstruktin realitetin. E ndërsa, normat e gazetarisë po zëvendësohen nga taktika manipulative më të sofistikuara se kurrë më parë, gazetarët duket se bien pre e manisë për të përcjellë çdo informacion ndërsa specialistët e manipulimit (spin-doctors) dhe specialistët e marrëdhënieve me publikun po i çorientojnë gazetarët nga misioni i tyre i vërtetë, misioni publik. Ajo që

ndodhi në konfliktin në Ukrainë u përcoll nga mediat ruse me një dozë të madhe propagandistike dhe lajmesh të rreme (fake news), ndërsa mediat perëndimore në ecurinë e punës së tyre ditore u bënë pre e makinerisë së rëndë të propagandës së sofistikuar ruse. Edhe pse, ato shpesh u pozicionuan si denoncuese të taktikave të përdorura nga qeveria ruse dhe mediumit të mbështetur prej saj, ato nuk i shërbyen asnjë gjejë tjetër veçse kontribuonin edhe më shumë në mpirjen e publikut duke i dhënë më shumë peshë kësaj lufte të informacionit. Kjo po e bën edhe më shumë të parashikueshme mediat perëndimore, e cila, tashmë, në realizimin e misionit të saj për transmetimin e çështjeve të ndryshme të politikës ndërkombëtare po bëhen, si pa dashje, pre e taktikave manipuluese të shtetarëve ambiciozë. Situata e re e konfliktit dhe era e informacionit po marrin një stil perëndimor, që po ndikon në mënyrën se si mediat dhe politika e jashtme po ndërveprojnë në mënyrë të pandarë nga njëra tjetra.

## ***Bibliografia***

Graber. Doris A. *Mass media and American politics* (6<sup>th</sup> edition). Congressional Quarterly Press: Washington, DC: 2002.

Gurevitch, Michael. "The globalization of electronic journalism". Në: Curran, James & Gurevitch, Michael (Ed). *Mass Media and society*. London: 1991 (178-193).

Larson, James, F. *Global television, and foreign policy*. Foreign Policy association. New York: 1998.

## **Webliografi**

Huffington post 18 mars 2014 – 30 mars 2014